



Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime
Center for Counseling, Social Services and Research

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME SIT

RAPORTI VJETOR

JANAR - DHJETOR 2022

RRETH VITIT TË KALUAR...

2022 KA QENË EDHE NJË TJETËR VIT I SUKSESSHËM SA I PËRKET PROJEKTEVE TË REJA, ANËTARËVE TË RINJ TË STAFIT, DHE IMPLEMENTIMIT TË VAZHDUESHËM TË PROGRAMEVE TONA. NATYRISHT, NUK DO TË MUND T'IA DILNIM PA PËRKRAHJEN E PARTNERËVE TONË, DUKE PËRFSHIRË PARTNERËT VENDOR, KOMBËTARË DHE NDËRKOMBËTARË, VULLNETARËVE TONË, DHE ANËTARËVE/EVE TË ÇMUAR/A TË BORDIT DHE KUVENDIT. SËRISH KEMI REALIZUAR TRAJNIME DHE HULUMTIME TË SHUMTA, KEMI MBAJTUR FUSHATA DHE NGJARJE FUQIZUESE DHE KEMI TARGETUAR SHUMË ANËTARË/E TË KOMUNITETIT.

- STRATEGJIA: KADRI GASHI
- FINANCAT: AGON OSAJ
- PROJEKTET: NJOMZA BERISHA



PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR OFRON NJË PËRMBLEDHJE GJITHËPËRFSHIRËSE TË ARRITJEVE TË ORGANIZATËS DHE NGJARJET MË TË RENDËSISHME GJATE VITIT TË KALUAR. SIT KA ARRITUR SUKSESE TË RËNDËSISHME NË SHUME FUSHA. RAPORTI OFRON DETAJE PËR PËRPJEKJET E ORGANIZATËS PËR T'I PËRMIRËSUAR OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, DUKE PËRFSHIRË PËRMIRËSIMIN E PËRVOJAVE TË TË RINJVE, ZGJERIMIN E KAPACITETIT PËR HULUMTIME, DHE PËRFORCIMIN E BASHKËPUNIMEVE ME SHOQËRINË CIVILE.

RAPORTI THEKSON INICIATIVAT E SIT PËR PROMOVIMIN E QËNDRUESHMËRISË DHE DIVERSITETIT, BARAZISË, DHE GJITHËPËRFSHIRJES. POASHTU ËSHTË PËRFSHIRË EDHE PERFORMANCE FINANCIARE, QË DËSHMON RRITJEN DHE STABILITETIN E VAZHDUESHËM FINANCIAR TË ORGANIZATËS. NË PËRGJITHËSI, RAPORTI VJETOR 2022 SHFAQ PËRPJEKJET E VAZHDUESHME TË ORGANIZATËS PËR ARRITJE TË PËRSOSMËRISË DHE NDIKIMIT POZITIV NË SHOQËRI.

VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM I ORGANIZATËS

STRATEGJIA



VIZIONI

Ne synojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse ku të gjithë ndjehen të sigurt, të barabartë, dhe mund të arrijnë potencialin e tyre pavarësisht identiteteve të tyre sociale.

MISIONI

SIT ka për qëllim të promovojë dhe të krijojë një shoqëri të barabartë për të gjithë. Kështu që, ne trajtojmë disa nga problemet më sfiduese të të drejtave të njeriut në shoqërinë tonë që na pengojnë për të arritur barazi, paqe, dhe zhvillim, përfshirë këtu dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Ne synojmë të arrijmë këtë duke përfshirë njerëz të të gjitha prapavijave, pa marrë parasysh gjininë, orientimin seksual apo ndonjë kategori tjetër të identitetit.

GJENDJA FINANCIARE NË FUND TË VITIT

- TË HYRAT TOTALE : 208,986.06€ GJATË VITIT 2022, NGA 138,805.76€ GJATË 2021
- SHPENZIMET TOTALE TË STAFIT: 119,302.41€ SHPENZIME TË STAFIT NË 2022, NGA 82,937.59€ SHPENZIME TË STAFIT NË 2021
- SHPENZIMET E PËRGJITSHME OPERACIONALE 2022: 80,409.85 EURO
- SHPENZIMET TJERA: 8,543.69

NJË VËSHTRIM I 2022...

SHTRIRJA

RRITJA

139.17%




SESIONE TË KËSHILLIMIT

232



TRAJNIMET

100



NGJARJET ONLINE

106

BURIMET E FINANCIMIT

- CARE International në Ballkan
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjencioni Austriak për Bashkëpunim (ADA)
- Fondacioni OAK
- Fondi për Paqe i Kombeve të Bashkuara (UNPBF)
- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)
- Këshilli Danez i Refugjatëve (DRC)
- SIDA
- Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)
- Koalicioni për Shëndetësi (K10)
- UN Women Kosovo
- UN Women në Turqi
- Rrjeti Evropian për punën me ushtruesit e dhunës në familje – WWP EN
- Kosova - Women for Women
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore
- Agjensia për Barazi Gjinore
- United Nations Kosovo Team
- Fondi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR KËSHILLIM



STOPP – Përkrahja e implementimit të programeve rehabilituese për ushtruesit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje sipas neneve 12 dhe 16 të konventës së Stambollit

Projekti ka filluar në maj 2021 dhe ishte në implementim deri në nëntor 2022. Rrjeti Ndërkombëtar për Punën me Ushtruesit e Dhunës në Familje, në partneritet me UN Women është duke implementuar projektin “Përkrahja e implementimit të programeve rehabilituese për ushtruesit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, sipas neneve 12&16 të Konventës së Stambollit”.

Ky projekt synon të rrisë sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe fëmijëve duke penguar dhe parandaluar sjelljet e dhunshme. Projekti do të vlerësojë nivelin e reagimit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë ndaj neneve 12 dhe 16 të Konventës së Stambollit dhe do ta trajtojë atë duke u fokusuar në forcimin dhe mbështetjen e programeve të ushtruesve të dhunës në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë. Duke pasur parasysh rëndësinë e praktikave pozitive transformuese të maskulinitetit, një fokus specifik do të jetë tek të rinjtë përmes aktiviteteve të ndryshme: duke punuar me profesionistë të shkollës dhe drejtpërdrejt me të rinjtë. Në fund, projekti do të përfshijë palët e interesuara dhe politikëbërësit përkatës dhe do të nxisë rritjen e ndërgjegjësimit në rajon.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR KËSHILLIM



Këshillim për Parandalim II: Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte puna me ushtruesit e dhunës, ofrimi i këshillimit për mosrespektuesit e ligjit, dhe përfshirja e tyre në programet rehabilituese të ofruara në komunitetin e tyre. Puna praktike me ushtruesit e dhunës bohet përmes sesioneve individuale të këshillimit, sesioneve grupore të këshillimit, dhe shërbimeve online të implementuara në shtatë rajonet kryesore të Kosovës (Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni, Ferizaj, Gjilani, dhe Gjakova.).

ARRITJET KRYESORE:

- Lansimi i raportit “Perceptimet dhe qëndrimet ndaj koncepteve gjinore dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë; Analizë e akterëve institucional dhe popullsisë së përgjithshme”
- Janë mbajtur 32 sesione këshillimi. 28 raste janë referuar nga familjarët dhe katër (4) raste nga zyrtarët policer dhe shërbimet korrektuese të Kosovës
- Kemi mbajtur gjashtë (6) takime avokuese me Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje me akterë nga komunat e ndryshme (udhëheqës fetar, profesorë universitar, OSHC, etj. për të biseduar për proceset e ndryshme për punën me ushtruesit e dhunës)
- Janë implementuar punëtori për ngritje të kapaciteteve me akterë të ndryshëm, gjyqtarë dhe prokurorë, Odën Kosovare të Avokatëve, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, njësitë e policies për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore
- Janë implementuar fushata vetëdijësuese për rëndësinë e përfshirjes së burrave dhe djemve të rinj dhe të grave në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje dhe për programet efektive psiko-sociale për ushtruesit e dhunës në Kosovë në nivelin e publikut dhe të komunitetit.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Përmirësimi i Aftësive të Rinisë për Menaxhim të Konfliktit

Që nga maji 2021, SIT filloi zbatimin e fazës së tretë të projektit të financuar nga DRC, këtë herë të quajtur "Përmirësimi i Aftësive të Rinisë për Menaxhim të Konfliktit". Projekti u udhëhoq dhe implementua nga SIT, dhe përfituesit e targetuar ishin të rinjtë nga komunat e Fushë Kosovës, Kamenicës, Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës së Veriut. Projekti kishte për qëllim të rinjtë nga këto komuna pasi që aty jetojnë komunitete të ndryshme dhe ka më shumë nevojë për tolerancë dhe bashkëpunim ndëretnik.

Përveç takimeve dhe punëtorive të mbajtura, janë ofruar edhe kurse të gjuhës angleze falas për pesë muaj. Pjesëmarrësit e projektit dhe të tjerët kishin mundësinë të bashkohen me klubet e të folurit dhe kurset fillestare për të përmirësuar aftësitë e tyre të të folurit dhe të kuptuarit në anglisht.

60 pjesëmarrës/e përfituan ose nga klubet e të folurit ose nga kurset fillestare. Të gjithë ata që ndoqën kurset fillestare hynë në testin përfundimtar dhe morën certifikatat e tyre sipas nivelit që kishin përfunduar dhe rezultateve të treguara në testin përfundimtar.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Përmirësimi i Aftësive të Rinisë për Menaxhim të Konfliktit

Projekti gjithashtu ka paraparë iniciativa për të ndihmuar komunitetet në komunat e targetuara. Për Shkollën Fillore “Selman Riza” në Fushë Kosovë është bërë një donacion prej 2340 librash.

Ky projekt është zgjatur edhe tre muaj të implementimit deri në shkurt 2022. Gjatë kësaj faze, përveç takimeve të rregullta me përfituesit, është bërë edhe donacion i tezgave në tregun multietnik në komunën e Kamenicës si pjesë e iniciativave në komunitet, propozuar nga të rinjtë.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Dialog për Paqe

Nga marsi 2022 SIT ka filluar implementimin e projektit "Dialog për Paqe " i mbështetur nga Këshilli Danez i Refugjatëve. Projekti ka targetuar të rinj/reja nga etni të ndryshme nga komunat Fushë Kosovë, Kamenicë (Dardanë), Mitrovicë Jugore, dhe Mitrovicë Veriore.

Objekiva kryesore e projektit ishte të punojë me rininë për t'i bërë avokues të fuqishëm që të luftojnë kundër stereotipeve dhe paragjykimeve me bazë gjinore. Gjatë kohës 10 mujore janë mbajtur 11 takime me përfituesit gjatë të cilave janë mbajtur punëtori të ndryshme. Përveç këtyre, janë organizuar edhe aktivitete si Bowling, mbrëmje filmi, dhe kampi rinor, për ta rritur kohezionin social ndërmjet të rinjve. Gjithashtu janë ofruar edhe kurse të gjuhës angleze falas për gjashtë (6) muaj. Pjesëmarrësit/et e projektit dhe të tjerët kishin mundësinë të bashkoheshin me klubet e të folurit dhe grupet fillestare për t'a përmirësuar nivelin e të kuptuarit dhe të të folurit të gjuhës angleze.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Dialog për Paqe

60 pjesëmarrës/e kanë përfituar nga këto klube të të folurit dhe nivelet fillestare. Të gjithë ata/o që kanë ndjekur kurset me nivele i janë nënshtruar një testi njohurish dhe i kanë marrë certifikatat bazuar në rezultatin e treguar në testin final.

Projekti gjithashtu ka pasur për qëllim implementimin e disa iniciativave në komunitet, bazuar në nevojat dhe kërkesat e përfituesve të projektit në komunat përkatëse. Dy parqe publike janë renovuar në Mintrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore në zonat multi-etnike.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



YOUTH VOICES, YOUTH CHOICES

Projekti ka filluar në janar të vitit 2021 dhe do të jetë në implementim deri në qershor 2023. Gjatë vitit të parë të projektit, janar-dhjetor 2021 është bërë një studim ndërkombëtar për rininë në pesë shtete të Ballkanit, respektivisht Kosovë, Bullgari, Bosnje dhe Hercegovinë, Shqipëri, dhe Maqedoni Veriore.

Bazuar në përvojën e COVID-19, ky projekt ka për qëllimin krijimin e një ambienti që është më përkrahës për shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues të orientuara kah rinia, kujdesi ndaj vetes, dhe informimi përgjatë dhe përtej emergjencave brenda rajonit të Ballkanit, me vëmendje të veçantë tek grupet më të cenueshme.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



YOUTH VOICES, YOUTH CHOICES

KJO SYNOHET TË ARRIHET:

- Së pari, duke hulumtuar për të kuptuar më mirë ndikimin e COVID-19 në qasjen e të rinjve në shërbimet dhe informacionet mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese, dhe mundësinë dhe nevojën për t'i integruar shërbimet dixhitale, veçanërisht për ata më të cenuarit
- Së dyti, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave të mira për të fuqizuar të rinjtë nëpërmjet një kombinimi të mjeteve të edukimit online/offline
- Së treti nëpërmjet zhvillimit të rekomandimeve (politikave) që do të mbështesin iniciativat e avokimit lokal dhe rajonal për të forcuar sistemet ekzistuese shëndetësore që sigurojnë qasje në shërbime dhe informacione (miqësore për të rinjtë) për të gjithë ata që kanë nevojë.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



YOUTH VOICES, YOUTH CHOICES

Hulumtimi është lansuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në evente me akterë relevant. Përveç lansimit, raporti poashtu është publikuar në web faqen dhe rrjetet sociale të organizatës sonë. Fletë informative mbi hulumtimin janë publikuar në rrjetet tona sociale çdo muaj.

Një tjetër arritje e periudhës së implementimit për këtë vit ishte takimi me Parlamentin e Bullgarisë për të biseduar për “Përkrahjen e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese në Ballkanin Perëndimor post-COVID”. Ky ishte diskutim ndërkombëtar me përfaqësues të të gjitha organizatave anëtare, dhe nga të gjitha panelet e diskutimit u dhanë rekomandime thelbësore për deputetët e Parlamentit Evropian.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



YOUTH VOICES, YOUTH CHOICES

Është mbajtur një tryezë kombëtare për diskutimin e ndikimit të COVID-19 në kërkesat e Shëndetit dhe të Drejtave Seksuale dhe Riprodhuese të (të rinjve) dhe nevojat e paplotësuara, praktikat premtuese/mekanizmat e reagimit dhe angazhimin për t'u qasur në shërbimet dhe informacionin në lidhje me ShSR për të krahasuar të dhënat nga terreni me të dhënat që institucionet zotërojnë, për ta nxjerrë një strategji të ardhshme të bazuar në rekomandime.

Gjatë kësaj faze të implementimit kemi mbajtur disa trajnime. Kemi përfshirë të rinj/reja në mënyra të ndryshme në lidhje me shëndetin riprodhues, të drejtat mbi shëndetin riprodhues, planifikimin familjar, infeksionet seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS, dhe fushata në rrjete sociale për avokim për shëndetin seksual dhe riprodhues.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



E ARDHMJA PËR RININË

Ky projekt ka për qëllim zgjerimin dhe përfshirjen e arritjeve të mëhershme lidhur me implementimin e programit transformues gjinor të aftësive jetësore, apo shkurt Programi Y. SIT synon ta implementojë këtë projekt përmes avokimit të targetuar dhe bashkëpunimit të ngushtë me akterët relevant përmes përkrahjes së ndërtimit të lëvizjes/koalicionit përmes zhvillimit të aleancave të reja që përfshijnë prindërit dhe qytetarët ta përkrahin programin arsimor të aftësive jetësore të fokusuar në barazi gjinore.

SIT si partner i CARE, bashkë me partnerët tjerë, do ta zhvillojë edukimin e aftësive jetësore për transformim gjinor për t'u bërë pjesë esenciale e programeve arsimore në shkolla dhe institucione korrektuese. Fokusi do të jetë pajisja e shkollave fillore, shkollave të mesme, dhe universiteteve për taligjëruar dhe udhëhequr me sukses implemetimin e programit të aftësive jetësore të CARE (Programi Y) dhe t'i përkrahë të rinjtë/rejat në tranzicionin e tyre të sigurt në moshën e pjekurisë.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



E ARDHMJA PËR RININË

Më tutje, projekti do ta pilotojë programin e aftësive jetësore të përgatitur enkas për rininë e rrezikuar në institucionet korrektuese të të miturve (Programi Y Plus) për ta parandaluar radikalizimin dhe për të kontribuar në risocializim.

E gjithë kjo do të vazhdojë nga komunitetet e mobilizuara që në mënyrë aktive inicojnë ndryshime të politikave arsimore. Të gjithë partnerët do të sigurojnë zëra publik më rendësishëm për rininë përmes lëvizjes E Ardhmja për Rininë, e krijuar paraprakisht nga CARE, dhe t'i fuqizojnë organet qeveritare për të zhvilluar strategji për ta institucionalizuar programin e aftësive jetësore përmes procesit të konsultimit me akterë nga shumë palë.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



E ARDHMJA PËR RININË

ARRITJET KRYESORE:

- Mbajtja e rregullt e punëtorive mujore të programit Y në Shkollën e Mesme Teknike “28 Nëntori” në Prishtinë
- Trajnimi i parë me studentët e Departamentit të Punës Sociale – Fakulteti i Filozofisë, Universiteti i Prishtinës
- Premiera e filmit “Dear Me” në Kino Armata, në bashkëpunim me YMCA në Kosovë
- Pjesëmarrja në Klubin Rinor të Lidershipit në Bosnje e Hercegovinë me anëtarët e klubit “Bonu Burrë”
- Promovimi i platformës “Kujdessex” në konferencën e organizuar nga Kolegji Heimerer në Prishtinë
- Trajnimi i parë i mësimitdhënësve të Shkollës së Mesme Teknike “28 Nëntori”
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Departamentin e Psikologjisë – Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës
- Organizimi i dy takimeve me Grupin Punues, duke përfshirë përfaqësues të MASHTI-t për institucionalizimin e Programit Y dhe prezantimin e draft strategjisë për institucionalizimin e programit Y
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë Komunale të Arsimit
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Shërbimin Korrektues në Prishtinë

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



BREAK THE ICE 2.0:

Projekti "Break the Ice 2.0" ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit mes të rinjve të Kosovës duke ndarë njohuritë, aftësitë, artin, dhe informacionin tek të gjitha komunitetet. Tutje, të rinjtë mund t'i tejkalojnë mangësitë në aftësitë e mendimit kritik duke u rritur në një kulturë e cila e vlerëson tolerancën, barazinë, paqen, dhe përfshirjen dhe inkurajon laramani kulturore, jo diskriminim dhe jo gjuhë të urrejtjes. Puna me rininë e ka qëllimin primar të fuqizimit të tyre për të qenë agjentë të ndryshimit, ta përdorin kulturën si vegël për ndryshim social, dhe ta rrisin qëndrueshmërinë ndaj konfliktit.

Ky projekt synon t'i bashkojë rininë e Fushë Kosovës, Kamenicës, Mitrovicës Jugore, dhe Mitrovicës Veriore të cilëve u intereson diversiteti kulturor për ta promovuar komunikimin dhe ta ndërtojnë një rrjet të të rinjve që janë të interesuar për art dhe kulturë. Si rezultat i përpjekjeve të tyre, këta të rinj mund ta ndryshojnë komunitetin e tyre dhe t'i përfshijnë të rinjtë e pafavorizuar dhe të privuar nga të drejtat e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Ata do të bashkohen, t'i tregojnë tregimet e tyre, ta luftojnë padrejtësinë dhe t'i eliminojnë paragjykimet. Ata/o poashtu do të marrin pjesë në ngjarje kulturore të dizajnuara për t'u ndihmuar të rinjve në Kosovë ta ndërtojnë një lëvizje konstruktive rinore e cila promovon paqe, zgjidhje të konfliktve, dhe përfshirje sociale.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Zhvillimi i Rinisë, Normat Gjimore dhe Siguria Njerëzore në Kosovë: Mbështetja e të rinjve si nxitës të barazisë gjimore, zhvillimit dhe paqes pozitive

Ky ishte një projekt afatshkurtër i cili filloi më 19 tetor 2022 dhe u implementua me mbështetjen e UNDP-së. Ky projekt synoi të vendoste bazat për krijimin e një projekt-propozimi të shëndoshë për të shtyrë përpara rekomandimet për barazinë gjimore të dala nga Forumi Rinor për Barazi Gjimore.

Këto rekomandime përfshinë tema të tilla si shëndeti dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, abuzimi seksual, arsimit gjithëpërfshirës, infrastruktura e hapësirës publike që siguron qasje për personat me aftësi të kufizuara dhe siguri për gratë dhe vajzat, siguria e shkollave, monitorimi i mediave dhe përmirësimi i mundësive të punësimit për gratë e reja. (veçanërisht në fushën e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë, dhe Matematikës). Për të arritur qëllimin e projektit, u krye një hulumtim teorik. U mbajtën dy tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues nga Forumi Rinor për Barazi Gjimore dhe aktorë relevantë nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Rinia për Përfshirje, Barazi, dhe Besim (Y4IET)

Ky projekt filloi në shtator të vitit 2022 dhe do të jetë nën implementim deri në shkurt 2024. Qëllimi i projektit do të jetë që të targetojë grupe të rinjve shqiptarë, serbë, romë, ashkali dhe egjiptianë dhe t'i trajnojë ata, nën mbikëqyrje të udhëhequr, për mendimin kritik dhe kreativ. Nëpërmjet trajnimit të edukimit joformal, SIT do t'i fuqizojë pjesëmarrësit t'i sfidojnë stereotipet sociale, të ndërtojnë identitetet e tyre hapur, përtej stereotipeve etno-nacionale, dhe të mendojnë në mënyrë kreative. SIT do t'u mundësojë pjesëmarrësve të realizojnë këtë qëllim së bashku përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në projekt. Pjesëmarrësit e trajnuar do të përhapin aftësitë dhe përvojën e tyre si shumëfishues, të cilët janë në rolet e tyre si të rinj, dhe SIT do të përdorë mjetet e përdorura për trajnimin e të menduarit kritik dhe krijues në trajnime të tjera.

Përmes këtij projekti, të rinjtë do të vazhdojnë trajnimin me përfaqësues të shoqërisë civile, autoriteteve komunale, rinisë, organizatave të grave, dhe gazetarëve të mediave për ngritjen e kapaciteteve për ngritjen e vetëdijes, fushatat, dhe aktivitetet në lidhje me mediat. Këto aktivitete SIT do t'i mbajë në gjashtë komuna, ku do të diskutohet për dialogun, avokimin, gjuhën e urrejtjes, narrativat përçarëse, barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NË KUADËR TË QENDRËS PËR SHËRBIME SOCIALE



Rinia për Përfshirje, Barazi, dhe Besim (Y4IET)

Si rezultat, ne do të zhvillojmë një manual për të menduarit kritik si pjesë e edukimit joformal dhe formal për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë më mirë veten, motivimet dhe qëllimet e tyre. Manuali do të përfshijë një sërë metodash, të tilla si arti i organizimit të metodave të lehtësimit, hulumtim për veprim, komunikimi jo i dhunshëm, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, teknikat e ndërtimit të ekipit, forum teatri, fotografia, vizatimi, zanatet, etj., për t'i luftuar paragjykimet dhe stereotipet ekzistuese. SIT gjithashtu do të ndajë manualin me institucione të tjera të arsimit joformal dhe edukatorë formal.

SIT do ta përfshijë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit në procesin e zhvillimit që ta kenë manualin në kurrikulë dhe ta përfshijnë në edukimin formal. Poashtu, disa nga pjesëmarrësit/et e trajnimeve do të përzgjedhen për të shkruajtur raporte/tregime lidhur me tema të ndjeshme si barazia gjinore, të drejtat e njeriut, gjuha e urrejtjes, maskuliniteti toksik, kohezioni social, dhe dhuna me bazë gjinore.

Ne kemi mbajtur katër (4) trajnime për ngritje të kapaciteteve këtë vit dhe do të vazhdojmë me trajnime të tjera vitin e ardhshëm.

KAMPANJAT



FESTIVALI I BABALLARËVE – EDICIONI I TRETË

Festivali i Baballarëve është i pari i këtij lloji në Kosovë, që promovon prindërimin pozitiv, rëndësinë e përfshirjes së baballarëve në rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve, ndarjen e përgjegjësisë të barabarta brenda familjes, dhe promovimin e pushimit prindëror

Ky festival u mbajt më 19 qershor 2022 (Dita e Baballarëve), tek platoja përballë Kino Armata, afër Hotel Grand-it në Prishtinë. Aktivitetet përbërëse ishin gara e baballarëve, ekspozita, muzikë, lojëra, podcast, kuiz, art, kulturë, piknik familjar, këndi i leximit, dhe tjera aktivitete interaktive.

Qëllimi i këtij festivali është t'i frymëzojë baballarët dhe kujdestarët ligjorë që të jenë të vëmendshëm dhe të përfshirë në mënyrë aktive në rritjen e fëmijëve, inicimit të diskutimit për rëndësinë e atësisë, me fokus të veçantë në avokimin për pushimin prindëror. SIT do ta implementojë këtë aktivitet çdo vit në Ditën e Baballarëve. Shumë partnerë lokal dhe ndërkombëtar e kanë përkrahur këtë festival, si UNFPA Kosova, CARE International në Ballkan, Agjencia Austriake për Zhvillim, Fondacioni OAK, Komuna e Prishtinës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Demokraci për Zhvillim.

KAMPANJAT



DITA NDËRKOMBËTARE E RINISË

Ky festival është mbajtur më 12 gusht 2022 në parkun e Taukbahçes. Të rinjtë nga rajonet e ndryshme të Kosovës si Prishtina, Fushë Kosova, Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Kamenica/Dardana, Zveçani, Ranillugu, etj., u mbledhën për ta festuar këtë ditë dhe për të mësuar aftësi të reja për jetën, shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, zgjidhjen e konflikteve dhe endërtimin e paqes, orinetimin në karrierë dhe tjera tema që ndërlidhen me rininë.

Tema e këtij viti ishte "Solidarizmi Integruar". Kjo temë na ndimonte të kuptojmë se si njerëzit e gjeneratave të ndryshme lidhen me njëri-tjetrin dhe ndihmojnë të varem tek njëri-tjetri në jetët tona të përditshme. Të vjetrit dhe të rinjtë përballen me këtë çështje dhe shpesh pësojnë dëm psikologjik afatgjatë i cili poashtu ndikon në shoqëri. Të rinjtë duhet të bashkohen, të angazhohen në aktivitete me nevojë dhe interesa të ndryshme, të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ta shprehin veten lirshëm. Target grupi ynë: nxënësit e shkollave të mesme, studentët (djem dhe vajza të moshave 15-26 vjeç), prindërit, komunitetet tjera, audiencat e rrjeteve sociale dhe mediave tradicionale në mbarë Kosovën, etj.

100 të rinj nga Prishtina, Fushë Kosova, Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Kamenica, Zveçani, Ranillugu, etj. janë arritur në mënyrë direkte (shqiptarë, serbë, romë dhe komunitete të tjera). Në mënyrë indirekte rreth 100,000 njerëz u vunë në targetuan në internet, nga mediat kombëtare dhe lokale dhe nga strategjia jonë e mediave sociale. Shëndeti Seksual dhe Riprodhues – kuizi i gjuetisë për thesarin: pyetje rreth Shëndetit Seksual dhe Riprodhues dhe të drejtave Seksuale Riprodhuese. Ky aktivitet u organizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.

KAMPANJAT



TUNELI I FUNDIT – EDICIONI I KATËRT

Në kujtim të viktimave të femicidit (vrasja e një gruaje apo vajze, veçanërisht nga një burrë dhe për shkak të gjinisë së saj) nga periudha e pasluftës në Kosovë, SIT ekspozoi disa histori të këtyre viktimave për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

SIT e ka ekspozuar këtë instalacion në tri komuna të Kosovës. Në Prishtinë më 1 dhjetor në sheshin "Zahir Pajaziti". Më 2 dhjetor në Prizren te "Kroi i Shatërvanit", dhe më 3 dhjetor në Pejë te sheshi "Skënderbeu". Kalimtarët patën rastin t'i lexojnë këto histori për të parë dhunën të cilën përjetojnë gratë në Kosovë vit pas viti. Këto storje u përgjigjen pyetjeve "Kush? Kur? Si? dhe Çfarë?", dhe shpresojmë që me këtë rast t'ua përcjellim mesazhin mediave kosovare se këto janë pyetjet që kanë rëndësi në raportimin e rasteve të dhunës dhe jo pyetja "Pse?" - sepse dhuna nuk ka justifikim! Në fund të instalacionit u vendos deklarata e "Zotimeve Publike" ku të gjithë zotohemi se do të jemi aktivë kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.

"Tuneli i fundit" dhe 16 Ditët e Aktivizmit implementohen nga SIT dhe mbështeten nga: UNFPA Kosovë, UN Women Kosova, Koalicioni K10, Care International në Ballkan, Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Fondacioni OAK.

KAMPANJAT



FUSHATA LOKALE E SUPERHERONJËVE

Kjo fushatë lokale u realizua në dy fshatra të Kosovës, Koretin në Kamenicë dhe Bishtazhin të Gjakovës. Qëllimi kryesor i kësaj fushate ishte edukimi dhe ndërgjegjësimi i brezit të ri mbi rëndësinë e riciklimit dhe materialeve të ripërdorshme. Grupi ynë i synuar ishin nxënësit e klasës së tretë, të katërt dhe të pestë. Gjatë gjithë kësaj fushate, ne i targetuam 100 nxënës.

Ne implementuam këtë fushatë lokale për të rritur njohuritë e studentëve për riciklimin dhe përfitimet dhe dobinë e tij. Studentët ishin entuziastë për studimin dhe zgjerimin e njohurive të tyre mbi këtë temë. Me ndihmën e fëmijëve pastruam shkollën dhe mbetjet i ndamë në kosha riciklimi. Gjithashtu mbollëm bimë zbukuruese për të ndihmuar në pastrimin e ajrit.


HULUMTIMET E REALIZUARA NË VITIN 2022



Hulumtimet e realizuara në vitin 2022

- “Perceptimet dhe qëndrimet ndaj koncepteve gjinore dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë – Analizë e akterëve institucional dhe popullsisë së përgjithshme” – i përkrahur nga UFPA në Kosovë.
- “Qasja e rinisë në informim, edukim, dhe kujdes për Shëndetin Seksual dhe riprodhues #ShSR në Kosovë gjatë kohës së COVID-it” – i përkrahur nga IPPF – Rrjeti Ndërkombëtar dhe MSD for Mothers.
- Programet për ushtruesit e dhunës në Ballkanin Perëndimor, rrjetëzimi i praktikave ekzistuese dhe rrugët për të vazhduar përpara.

INFORMATA SHITESË



EVENTET

- Premierë e filmit "Dear Me"
- Tryezë e rrumbullakët për prezantimin e të gjeturave të raportit "Qasja e të rinjve në informacion, edukim dhe kujdes ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues në Kosovë gjatë kohës së COVID-19" për akterët relevant nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare


KONFERENCAT

- Konferenca për Maskulinitetin Toksik - Angazhimi i Burrave dhe Djemve për Barazi Gjinore – i përkrahur nga UNFPA.
- Konferencë nacionale – E tashmja dhe e ardhmja e punës sociale në Kosovë, e organizuar nga Departamenti i Punës Sociale – Fakulteti i Filozofisë, Universiteti i Prishtinës.

Marketing Dixhital

- Shpërndarja e fletave informative në platformat e rrjeteve sociale. Fletat informuese përmbanin të dhëna nga hulumtimi i mbajtur për efektin e pandemisë COVID-19 tek të rinjtë si pjesë e projektit "Youth Voices, Youth Choices" – i mbështetur nga IPPF

INFORMATA SHITESË



KONFERENCAT

- Simpoziumi i 13 Ndërkombëtar i Shkencave Shëndetësore i organizuar nga kolegji Heimerer në Prishtinë.
- Konferenca “Kriza globale kërkon inovacion lokal” e organizuar nga Act Now, në Shtutgart, Gjermani.
- Takimi i partnerëve të MenEngage Europe në Berlin.
- Lansimi i raportit të hulumtimit “Qasja e të rinjve në informacion, edukim dhe kujdes ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues në Kosovë gjatë kohës së COVID-19” – i përkrahur nga IPPF.
- Takim i nivelit të lartë në Parlamentin Evropian në Bruksel, Belgjikë.

BASHKËPUNIME DHE PARTNERITETE

Universitetet dhe Kolegjet

- Universiteti i Prishtinës
– Fakulteti i Filozofisë,
Departamenti i
Psikologjisë

Institucionet lokale dhe nacionale

- Drejtoria Komunale
e Arsimit në Prishtinë;
- Shërbimi Korrektues i
Kosovës.

Rrjetet në të cilat SIT është anëtar

- ActNOW
- MenEngage
- MasterPeace
- MenCare/Fatherhood.
- Grupi për Gjini dhe Siguri
- Koalicioni për Shëndetësi (K10)
- Rrjeti Ndërkombëtar i Qendrave Rinore
- Youth for Exchange and Understanding
- International Planned Parenthood
Federation European Network;
- European Network for the Work with
Perpetrators of Domestic Violence

Qëndrueshmëria e SIT



SIT ka arritur qëndrueshmëri përmes projektit “E Ardhmja për Rininë” deri në vitin 2024 dhe përmes projektit “Youth Voices, Youth Choices” deri më 2023. Si rezultat i institucionalizimit të programit “Y”, SIT bashkë me prtnerët do të kontribuojë në sistemin e arsimit në Kosovë. Vlen të ceket se këtë vit kemi zhvilluar draft strategjinë për institucionalizimin e programit Y. Presim që deri vitin tjetër udhëzuesi për programin Y të përpunohet me ndihmën dhe përkrahjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit, dhe ky do të jetë një hap drejt institucionalizimit të Programit Y.

Tutje, jemi duke implementuar iniciativa ekzistuese dhe duke pritur fillimin e projekteve të reja. Rrjetet tona rajonale dhe botërore kanë sjellë shumë iniciativa të rëndësishme në Kosovë. Viti 2022 ka qenë një ndër vitet më të mira të gjenerimit të të ardhurave totale, dhe pa dyshim vitin 2023 do të jetë edhe më i mire.

RRUGA DREJT 2023

RISTRUKTURIMI I STAFIT

Drejtori Ekzekutiv i SIT mban takime individuale reflektimi me të gjithë anëtarët e stafit çdo gjashtë muaj. Këto takime reflektimi janë një nga mjetet që përdor SIT për të mbajtur evidencë për anëtarët e stafit dhe nevojat e tyre, dhe për t'i optimizuar rezultatet e tyre për të mbështetur rritjen e SIT. Deri kohët e fundit, menaxhimi i SIT ka eksperimentuar me shumë qasje për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të strukturuar departamentet e SIT dhe për të shpërndarë detyrat midis anëtarëve të stafit. Kah fundi i vitit 2022, menaxhmenti ka vendosur të testojë një metodë të re të shpërndarjes së detyrave.

Duke filluar që nga janari i 2023, koordinatorët/et e projekteve do të përpiqen të bëjnë më të mirën për projektet e tyre, që do të thotë se nuk do të kenë përgjegjësi direkte për menaxhimin e departamenteve. Për më tepër, pas vlerësimit të aftësive të tyre, praktikisht ata/o janë në pozitat ku mendojnë se mund të kontribuojnë më së shumti. Tutje, Drejtori Ekzekutiv do të fokusohet më shumë në rjetëzim, në Departamentin e Këshillimit, dhe në zhvillimin afatgjatë të organizatës. Në anën tjetër, Menaxherja për Programe dhe Zhvillim do të fokusohet më shumë në ngritje të fondeve, rjetëzim, dhe menaxhimin e stafit dhe departamenteve. Zyrtarja për Programe do të asistojë me ide për projekte dhe është përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun. Secili/a anëtar/e i/e ekipit, gjithësi, është i/e lirë të marrë pjesë/kontribuojë në rjetëzim, ngritje të fondeve, dhe prurjen e ideve të reja.

Kjo teknikë do të testohet për disa muaj, dhe nëse funksionon mirë, do t'i përmbahemi derisa ta gjejmë një më të mire. Nëse jo, do ta kërkojmë një tjetër opsion më të mire.



RRUGA DREJT 2023

Anëtarët e reja të ekipit:

- Fiona Haxhikadrija
- Elsa Rexhepaj
- Pashkë Shala
- Festina Cakolli

PROJEKTET E REJA:

- Dialog për paqe
- Rinia për përfshirje, barazi, dhe besim
- Këshillim për parandalim 2.0

PLATFORMAT E SIT

- www.sit-ks.org
- www.sitandbreaktheice.org
- www.sitandtalk.org/
- www.sitkosova.org
- www.ks.masterpeace.org/
- <https://www.kujdessex.net/>